



Pranimat / Dorezuar Pranijeno / Prizato Received / Delivered	07. 12. 2	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	7747/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A . Nr. 967/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi- Bajraktari, dhe Jeton Koca, anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A. Nr. 967/2022, të datës 01.11.2022, së ankueses me adresë banimi ,, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "Vlerësim i Punës ", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 06.12.2022, mori këtë;

V E N D I M

HEDHET POSHTË, si e palejuar ankesa me numër A. Nr. 967/2022, të datës 01.11.2022, së ankueses

A r s y e t i m

Ankuesja, sipas shkresave të lëndës e punësuar në Komunën e Prishtinës më datë 01.11.2022, me numër protokoll 6600/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, lidhur me vlerësimin e punës nga viti 2018, deri në vitin 2022, ankuesja pretendon se nuk i është bërë vlerësimi i rezultateve në punë për dy vitet e fundit edhe njëjta është penguar të ketë në dispozicion vlerësimet për aplikime në vende të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 02.11.2022, ka bënë kërkesë për përgjigjen në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa më datë 18.11.2022, Komuna e Prishtinës, ka dërguar përgjigje në ankesë tek Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 967/2022 e datës 01.11.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 5043/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili i datës 02.09.2022; E-maili i datës 30.03.2018; Akt Emërimi i datës 01.02.2017; Përgjigje në ankesë e datës 18.11.2022, me numër protokolli 7220/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të gjithave shkresave të bashkëngjitura në lëndë, konstatoi se ankesa e ankueses është e pa lejuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses, nuk e ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë, nga viti 2018, deri në vitin 2022, edhe për kundër faktit që Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës i ka njoftuar udhëheqësit e drejtpërdrejtë për vlerësimin e punës. Ankuesja me datë 02.09.2022, është drejtuar përmes imellit zyrtar mbikëqyrëses së drejtpërdrejt për vlerësim të punës së paku për dy vitet e fundit, por ankuesja nuk ka marrë përgjigje.

Kolegji i Këshillit pas analizimit të tërësishëm të shkresave të lëndës dhe dispozitave ligjore lidhur me pretendimin e ankueses, ka konstatuar se ankuesja kundër vlerësimit të rezultateve në punë ankesën në Këshill, e ka parashtruar në kundërshtim me nenin 43, paragrafi 1, të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se; 1. "Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues", prandaj ankuesja kur nuk është ftuar ti bëhet vlerësimi i punës deri më 31 janar 2022 e njëjta ka qenë dashur të filloj procedurat ligjore të ankimimit sipas nenit 13, paragrafi 1,3 të Rregullores nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se; 1. "Nëse nëpunësi civil nuk pajtohet me vlerësimin përfundimtar të mbikëqyrësit, ka të drejtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; 3. Afati për ushtrimin e ankesës së në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni është tridhjetë (30) ditë nga dita e marrjes së formularit të vlerësimit për nga nëpunësi".

Nisur nga kjo që u përshkrua më lartë ankuesja ka pareshtur ankesë në KPMSHCK në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjegjësisht nenin 127 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 'Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ".




Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, Prishtinë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A NR. 967/2022**

Rushit KAJTAZI



Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

